



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO			
MINISTRI E PËRGJEGJËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL			
MINISTRI E PËRGJEGJËSISË SHUMARSTVIA RURALNOG RAZVOJA			
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT			
Arhivi Qendror - Centraln Arhiva - Central Archive			
Nr./Br.No.	3326		
Nr./fa./Br./Str.No	2		
Data/Datum/Date	10.08.2023		
PRISHTINE PRISTINA PRISTINA			

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-292/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Taifun i prodhuesit “Adama Agan Ltd”, Izrael nga përfaqësuesi i saj “Agromarket KS”, Prishtine.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Herbicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Glyphosate, isopropylamine salt.....480g/l

4. PËRDORIMI:

Taifun është herbicid jo selektiv sistemik i cili lufton barërat e këqija një dhe shumëvjeçare gjethengushta dhe gjethegjera që përdoret në kashta, në sasinë 3-10 l/ha (30-100ml na 100 m²) trajtimi gjate kohës së rritjes intensive të barojave, foliarë(gjethore) përmes tokës me shpenzime të ujit 200-400 l/ha ujë(2-4 l na 100 m²).

Ne sasinë 3 l/ha, 6 l/ha dhe 10 l/ha

Lufton mirë (> 90 %) barojat si: Abutilonin (Abutilon theophrasti), Ambrozia (Ambrosia artemisifolia),Minueri i bardhë (Chenopodium album), tatulla (Datura Stramonium), barpate (Polygonum aviculare),domatja e zezë (Solanum nigrum), Sorhumi (Sorghum halepense), gjethë pjeshka(Veronica Persica).

70- 90% lufton barojat me rizome: Sorghum Halepense (Talla e eger), Cynon Dactylon (Krisja e arave)< 75 % Dobët lufton barojat si: Convolvus Arvensis (dredhja e arave), Cynon Dactylon (Krisja e arave)

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

250ml, 1L, 20L, 200L, 500L, 1000L

6. VËREJTJE:

- Duhet patuar kujdes Sasi me në një intensitet më të ulët pas korrjeve, fazat e hershme të rritjes së barërat e këqija, kushtet më të favorshme të motit dhe sasi të më të vogla të ujit.
- Duhet rritur doza e preparatit gjate rritjes intensive te barojave, normalisht edhe sasia e ujit.
 - Zonat e trajtuara janë të ndaluara për të kullotur kafshët dhe për të përdorur barin e thatë për ushqim.
 - Futja e bagëtive dhe përdorimi i barit të thatë për ushqimin e kafshëve është e mundur pas 7 ditësh nga aplikimi.
 - Zona e trajtuar e kashtës nuk duhet të përpunohet së paku 7 ditë pas aplikimit.
 - Masa e lënget ose e thatë, nga zonat e trajtuara nuk duhet të përdoret për përgatitjen e plehrave, e cila përdoret në prodhimin e perimeve.
 - Barërat e këqija të trajtuara nuk duhet të prishen ose të nxirren të paktën 2-3 javë pas aplikimit.
 - Gjate trajtimit, parandaloni rënien e pikave në të korrat ngjitur dhe te mbjellat tjera.

7. KARENCA:

Nuk është e definuar për përdorim ne stërnishta.
Puna e karences 12 ore.

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS09 - paralajmërim (cat 1)-i rrezikshëm për ambient

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar ne Databazën e Pesticideve te BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.

